



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Shkurt 2023

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Shkurt 2023

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen  
aktivitetet për muajin shkurt të vitit 2023)**

### KPK kundërshton koeficientin e caktuar nga Qeveria e Kosovës

KPK-ja ka njoftuar opinionin publik se në vazhdimësi ka marrë pjesë në grupet punuese gjatë procesit të hartimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, me ç'rast ka ofruar propozime dhe komente konkrete lidhur me këtë ligj, por të cilat nuk janë marrë parasysh nga organet përkatëse.



Rrjedhimisht, me rastin e publikimit të vlerës së koeficientit nga ana e Qeverisë, faktikisht, vërtetohet hapur se janë ulur ndjeshëm pagat e prokurorëve të shtetit dhe pagat e një pjese të stafit administrativ në sistemin prokurorial të Kosovës.

Më këtë rast, duke shprehur kundërshtimin tonë të fuqishëm lidhur me caktimin e koeficientit të pagave, kërkojmë edhe njëherë që të realizohet kërkesa e Këshillit Prokurorial drejtuar Avokatit të Popullit për referimin e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

KPK konstaton përfundimisht se me këtë rast është cenuar funksionalizimi i sistemit prokurorial, ngaqë pretendimet e ngritura me kohë janë të mbështetura në aktet, praktikat dhe standardet ndërkombëtare dhe, të cilat nuk mund dhe nuk duhet të cenojnë pavarësinë dhe funksionalizimin e asnjë pushteti.

## Diskutohet bashkëpunimi në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe institucioneve mbi Konventën e Stambollit

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Drejtoreshën Ekzekutive të Organizatës Joqeveritare “Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion – QIKA”.



Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për thellimin e bashkëpunimit për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe institucioneve mbi Konventën e Stambollit për Luftimin dhe Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave.

## Diskutohen aktivitetet e përbashkëta në mes të KPK-së dhe Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe ekspertët e projektit KOSEJ.



Temë e diskutimit ishte thellimi i bashkëpunimit të mëtejshëm për zbatimin e fazës së tretë të projektit KoSEJ. Meqenëse, projekti është në fazën fillestare, në këtë takim u diskutuan edhe aktivitetet e përbashkëta, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, duke përdorur metodologjinë e CEPEJ-it.

## Kryesuesi Maloku priti në takim Ambasadorin e Suedisë, Jonas Westerlund

Kryesuesi i KPK-së priti në takim Ambasadorin e Suedisë në Prishtinë.



Kryesuesi falënderoi Ambasadorin suedez për mbështetjen që Ambasada suedeze në Prishtinë ka dhënë dhe është duke vazhduar të japë për sistemin prokurorial të Kosovës. Kjo mbështetje vlerësohet në kuadër të angazhimeve të rëndësishme për realizimin e objektivave dhe synimeve të sistemit prokurorial të Kosovës.



Kryesuesi dhe Ambasadori, vunë theksin në mënyrë të veçantë në diskutimin për thellimin e bashkëpunimit për luftimin e dhunës në familje, krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe përgjithësisht forcimit të sundimit të ligjit dhe rendit në Kosovë.

## Mbahet punëtori për shqyrtimin e Raportit dhe Planit të punës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i mbështetur nga projekti EUKOJUST, organizoi një punëtori për diskutimin dhe shqyrtimin e Raportit të punës për vitin 2022 dhe Planin e punës për vitin 2023, në cilën morën pjesë Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, njëherësh kryesues i Komisionit për Administrimin e Prokurorive, administratorë të

prokurorive, stafi i Sekretariatit dhe i Njësitit të KPK-së, edhe përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë.



Punëtorja është ndarë në sesione, ku në fillim është diskutuar për Raportin e punës të vitit 2022 të Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe sfidat më të cilat është ballafaquar në realizimin e planifikimeve të punës, ndërsa sesioni i dytë është karakterizuar më diskutime për planifikimet e punës për vitin 2023.

### Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative mbajti takimin e radhës, me ç'rast ka proceduar me rendin e paraparë të ditës, me ç'rast është shqyrtuar drafti i udhëzimi për hartimin e akteve normative, i cili përcakton procedurat e draftimit të akteve normative në sistemin prokurorial.



Anëtarët e Komisionit, theksuan se ky udhëzim do të jetë bazament i mirë për draftimin e akteve normative të sistemit prokurorial.

### KPK-ja dënon gjuhën kërcënuese të Ministres Haxhiu, të përdorur sot ndaj Prokurorit Beqiri

Këshilli Prokurorial i Kosovës dënon gjuhën me përmbajtje kërcënuese të Ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ndaj prokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, Iliaz Beqiri, të përdorur në seancën e sotme gjyqësore ndaj saj, në të cilën akuzohet për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës.

KPK-ja i bënë thirrje Ministres Haxhiu edhe një herë që të përmbahet nga deklaratat e vazhdueshme kërcënuese ndaj sistemit prokurorial të Kosovës në përgjithësi dhe ndaj punës së prokurorëve në veçanti, sepse gjuha e saj e përdorur është tentativë për ndërhyrje në punën e pavarur të Prokurorit të Shtetit.



Në anën tjetër, KPK-ja do të vazhdojë fuqishëm të mbështesë dhe të mbrojë me të gjitha mjetet juridike në dispozicion punën profesionale të të gjithë prokurorëve të Republikës së Kosovës.

### KPK-ja i përmbahet deklaratës së përbashkët që pritet të nënshkruhet me KGJK-në dhe MD-në

Me qëllim të fuqizimit të vazhdueshëm të sundimit të ligjit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në koordinim të plotë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, është angazhuar për konkretizimin e veprimeve që dërgojnë në qartësimin dhe fuqizimin e kuadrit ligjor, të cilat rregullojnë këto dy institucione.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, së bashku me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë, është zotuar që, përmes një deklaratë të përbashkët, e cila pritet të nënshkruhet, të themelojë grupe të përbashkëta punuese për vlerësimin, konceptualizimin dhe draftimin e nismave ligjore, me qëllim të qartësimit, amendamentimit dhe fuqizimit të kuadrit ligjor në fushat, që ndërlidhen me vlerësimin e performancës, procesin e rekrutimit, emërimit dhe riemërimit, sistemin e disiplinimit, zhvillimin profesional dhe statusin e

prokurorëve dhe gjyqtarëve, forcimin e mekanizmave për deklarim të pasurisë së prokurorëve dhe gjyqtarëve, sistemin e verifikimit të profilit të kandidatëve për prokurorëve dhe gjyqtarëve, si dhe zbatimin e rekomandimeve nga misioni TAIEX për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit (2022).



Institucionet nënkruese të kësaj deklarate, duke respektuar pavarësinë e institucioneve të tjera, konkretisht, pa paragjykuar Komisionin Ad hoc të Kuvendit të Republikës së Kosovës rreth amendamenteve kushtetuese dhe ligjore për vetingun dhe në linjë me opinionin e Komisionit të Venecias, respektivisht, me rekomandimin e këtij opinionin “për të hyrë në dialog të plotë me Këshillat”, zotohen për ta jetësuar pakon ligjore, me qëllim të fuqizimit të sundimit të ligjit në Kosovë.

Në fund, të gjitha veprimet e parapara do të jenë në bashkërendim të plotë me partnerët ndërkombëtarë.

### Finalizohet Draftudhëzimi administrativ për hartimin e akteve normative

Përmbyllja dhe finalizimi i draftit të Udhëzimit për hartimin e akteve normative ishin në fokus të takimit të sotëm të Komisionit për Çështje Normative.



Fillimisht, gjatë këtij takimi është aprovuar raporti për monitorimin e akteve normative, i cili është hartuar pas vizitave të bëra në prokuroritë e Republikës së Kosovës.

Më tutje, në këtë takim, u shqyrtua drafti final i Udhëzimit administrativ për hartimin e akteve normative i cili përcakton procedurat e draftimit të akteve normative në sistemin prokurorial, me ç'rast krijon bazamentin i nevojshëm për mënyrën dhe metodat e hartimit të këtyre akteve të rëndësishme.

Komisioni aprovoi draftin e udhëzimit dhe i njëjti do të dërgohet për miratim në njërën nga takimet e radhës së KPK-së.

### Mbahet Takimi i 227-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

KPK-ja mbajti Takimin e 227-të me radhë, në të cilin miratoi me rekomandime Raporti i Komisionit Mbikëqyrës për zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike për vitin 2022.



Këshilli Prokurorial ka miratuar Raportin e Komisionit për avancimin e tre prokurorëve nga prokuroritë Themelore në Prokurorinë e Apelit, si dhe mori vendim për të bërë shpalljen për avancimin e pesë prokurorëve në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

KPK-ja themeloi një panel hetimor për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe miratoi Udhëzimin Administrativ për Hartimin e Akteve Normative të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Planin e Personelit për vitin 2023, si dhe trajtoi dy raste disiplinore.

### Reagim i anëtarit të KPK-së, Agron Beka

Reagim ndaj veprimeve tendencioze dhe të shtrembëruara të IKD-së, në emisionin e datës 18.02.2023 dhe shkrimeve/reagimeve të datës: 24.02.2023.

1. Organizata Joqeveritare IKD edhe njëherë rikonfirmoi se është duke vepruar me porosi ose është në lajthim, gjegjësisht e manipuluar, lidhur me



informatat e plasura në emisionin "Betimi për Drejtësi", të transmetuar në KTV më 18.02.2023 dhe në shkrimet/reagimet e saja të këtyre ditëve.

2. Kjo OJQ me veprimet e saja po tenton që të bëjë ushtrimin e ndikimit në institucionet prokuroriale, në fazën kur prokuroria është duke i marr veprimet hetimore ndaj disa zyrtarëve publik (për të cilat i kam paralajmëruar me emailat e datës 2.02.2023 dhe 6.02.2023).

3. Vetë fakti se kjo OJQ ka PADI PËR SHPIFJE DHE FYERJE nga unë si paditës (nga viti i kaluar), seancë që do të mbahet me datë 3.03.2023 në Gjykatën Themelore në Prishtinë shpërfaq tendencën e caktuar të kësaj OJQ-je.

4. Kjo OJQ ka tendencë që me emisione dhe shkrime të saja t'i zbeh mbi 250 dëshmi që i kam dorëzuar në prokurori (me kallëzimin penal) ndaj disa zyrtarëve publik, që janë të pandehur/të dyshuar nga prokuroria për vepra të ndryshme penale dhe katër aktakuzat e ngritura ndaj zyrtarëve publik.



5. Këtë OJQ e kam njoftuar me datë 2.02.2023 dhe 6.02.2023 se kur t'i përfundoj prokuroria veprimet e saja hetimore lidhur me rastet konkrete, shprehi gadishmëri për deklarim dhe pjesëmarrje në emisionet e juaja lidhur me të gjitha çështjet që ju interesojnë.

6. Kjo OJQ në vend se ta përkrah parandalimin dhe luftimin e dukurive abuzive të iniciuara nga ana ime, ndërmerr veprime krejtësisht të kundërta.

7. Zyrtarët përgjegjës të kësaj OJQ-je duhet ta kuptojnë se në terminologjinë juridike/ligjore NUK EKZISTON termi "KËRCËNIM" ME PADI dhe cilësimi i

tillë është një gabim serioz profesional, juridik dhe logjik.

8. Kjo OJQ fushëveprimtari të saj zyrtarisht të deklaruar e ka EDUKIMIN/TRAJNIMIN, për të cilën edhe është themeluar si OJQ, e jo ta tejkalojë misionin dhe qëllimin për të cilën është themeluar.

9. Duke u nisur nga tërë këto, kjo OJQ prapë (ripërsëritës) po hynë në fushën e shpifjeve dhe fyerjeve me shkrimet, reagimet e tyre. Prandaj, marrja e veprimeve të mëtejme ligjore (nga ana ime) në organet e sistemit të drejtësisë do të jetë e pashmangshme.

10. Sa për informacionin e opinionit publik: Si anëtar i KPK-së deri më tani kam dërguar me dhjetra shkresa zyrtare KPK-ës, ku i kam qitur në pah thuaja shumicën e problemeve dhe vështirësive serioze me të cilat ballafaqohet sistemi prokurorial i Kosovës dhe KPK-ja.

Me respekt,

Prof.Asoc.Dr.Agron Beka

Anëtar i KPK-së

### Fillon hartimi i Draftregullore për shtesat e të punësuarve në sistemin prokurorial

Grupi punues për hartimin e draftit të Rregullore për shtesat e të punësuarve në sistemin prokurorial mbajti takimin e parë për hartimin e draftit të Rregullore për shtesat e të punësuarve në sistemin prokurorial.



Ky draft i kësaj rregulloreje do të shërbejë për rregullimin e pagesës së të gjitha shtesave, të cilat do t'u takojnë të punësuarve në sistemin prokurorial, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe në bazë të rregullore përkatëse.

Gjatë takimit, u tha se ky grup punues do të finalizojë këtë draftregullore brenda një afati sa më të shkurtër kohor dhe i njëjti do të dërgohet për miratim në njërën

nga takimet e radhës së Komisionit për Çështje Normative të KPK-së.

### Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariatit të KPK-së, gjatë muajit shkurt, ka dhënë kontribut profesional në punëtorinë dyditore për hartimin e planit të punës (2023) së Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe për hartimin e raportit vjetor (2022).

Gjithashtu është mbajtur një konsultë me ekspertët e CEPEJ-it, ku është diskutuar mundësia e ofrimit të mbështetjes për përgatitjen e formave statistikore që gjenerohen nga SMIL-i lidhur me vlerësimin e prokurorëve duke zbatuar SMIL dhe çështje të tjera, si dhe është mbajtur një takim me ekspertët e Projektit EukoJust.

Po ashtu është raportuar për Strategjinë për sundim të ligjit për periudhën korrik-dhjetor 2022.

SKPK-ja ka bashkëpunuar me UNDP-në për zbatimin e procedurave për zhvillimin e uebportalit të sistemit prokurorial të Kosovës, i cili do të fillojë së shpejti së punuari në fazat e parapara deri te finalizimi i tij.